

Në bazë të neneve 5 dhe 8 të Ligjit mbi zhvillimin regional të Malit të Zi („Fleta Zyrtare e MZ“ numër 20/11, 26/11 dhe 20/15) dhe nenit 38 paragrafi 1 pika 3 të Statutit të Komunës së Tuzit („Fleta Zyrtare e MZ“ numër 24/19), Kuvendi i Komunës së Tuzit në seancën e mbajtur më 08.08.2019 ka sjellë

V E N D I M

mbi qasjen e hartimit të planit strategjik për zhvillimin e Komunës së Tuzit

Neni 1

Qaset hartimit të Planit strategjik të zhvillimit të Komunës së Tuzit (në tekstin e mëtejshëm: Plani Strategjik).

Neni 2

Me planin strategjik përcaktohet gjendja ekzistuese e zhvillimit të njësisë së vetëqeverisjes lokale, qëllimi i përgjithshëm i zhvillimit, qëllimet strategjike me prioritete për realizimin e tyre, masat dhe udhëzimet për realizimin e planit strategjik, mjetet orientuese për realizimin e planit strategjik, mënyrën e sigurimit të tyre dhe çështje të tjera me rëndësi për zhvillimin.

Neni 3

Hartimi i Planit strategjik bëhet në bazë të Rregullores mbi metodologjinë për hartimin e planit strategjik të zhvillimit të njësisë së vetëqeverisjes lokale („Fleta Zyrtare e MZ“ numër 68/16).

Neni 4

Kryetari i Komunës me Vendim do të emëroj Koordinatorin dhe Grupin punues për hartimin e Planit Strategjik.

Kryetari i Komunës, me propozim të koordinatorit, do të sjellë Vendim mbi formimin e grupit Konsultues për përgatitjen e Planit Strategjik.

Neni 5

Plani strategjik sjellët në periudhë deri në 7 (shtatë) vite, pas pëlqimit të fituar nga ana e Ministrisë së ekonomisë mbi përshtatshmërinë me Strategjinë e zhvillimit rajonal të Malit të Zi.

Neni 6

Afati për hartimin e Propozimit të planit Strategjik është 6 (gjashtë) muaj.

Neni 7

Mjetet për hartimin e planit strategjik do të sigurohen nga Buxheti i Komunës dhe donatorët.

Neni 8

Ky vendim hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në „Fletën zyrtare të Malit të Zi – dispozitat komunale“.

Numër: 02-030/19-4677

Tuz, 08.08.2019

KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT

Kryetari,

Fadil Kajoshaj